



Në bazë të nenit 48, paragrafit 1.4. të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 25.03.2022 merr

## V E N D I M

### *për plotësim-ndryshim të Rregullores për studimet master*

#### I.

Plotësohet-ndryshohet Rregullorja për studimet master në UShAF nr. 3379/21 e datës 03.11.2021.

#### II.

Plotësohet-ndryshohet neni 48 dhe teksti i ri i këtij neni riformulohet kështu:

- 1. Të gjitha propozimet e titujve të temave të diplomës, të cilat vijnë nga mësimdhënësit dhe studentët, shqyrtohen nga komiteti i programit.*
- 2. Komiteti i programit ka të drejtë të pranoj, ndryshoj, kthej mbrapa për ndryshim/plotësim apo edhe të refuzoj titullin e temës së propozuar të diplomës nga mësimdhënësit apo edhe studentit/tës që e propozon atë.*
- 3. Në rastet kur tema e diplomës aprovohet nga komiteti i programit, për temat të cilat kanë qenë të propozuara nga mësimdhënësit, propozohet komisioni vlerësues, ndërsa, për temat që propozohen nga studentët, propozohet mentori dhe komisioni vlerësues.*
- 4. Komisioni për studime master shqyrton titujt e temave të diplomës të propozuara nga mësimdhënësit ose studentët, pasi ato paraprakisht të marrin aprovimin e komitetit të programit respektiv në të cilin është regjistruar studenti'ja, dhe i propozon Këshillit aprovimin e tyre. Gjithashtu, Komisioni për studime master shqyrton propozimet e komitetit të programit për mentor respektivisht anëtarët e komisionit vlerësues të temës së diplomës (komisioni vlerësues) dhe rekomandon Këshillit aprovimin e tyre.*
- 5. Komisioni për studime master ka të drejtë të ndryshoj, kthej mbrapa për ndryshim/plotësim apo edhe të refuzoj titullin e temës së propozuar nga Komiteti i programit. Gjithashtu, Komisioni për studime master ka të drejtë të ndryshoj edhe mentorin dhe anëtarët e komisionit vlerësues të propozuar nga Komiteti i programit.*

ndërsa pika 3 e nenit 48, nuk pëson ndryshime vetëm se renditet në pikën 6 dhe atë si në vijim:

6. Punimi i masterit paraqet punën e pavarur shkencore të kandidatit me të cilën ai tregon që ka përvetësuar njohuri për të zgjedhur probleme dhe detyra shkencore e profesionale.

III.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

1. Komisionit për studime master;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit.

Rektori

Prof. Dr. Agron BAJR





**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**  
FERIZAJ

Rektori  
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 3379/21; Datë: 03.11.2021

Në bazë të nenit 48 paragrafit 1.4 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 03.11.2021, merr

**V E N D I M**

I.

Miratohet Rregullorja për Studimet Master në UShAF.

II.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

**A r s y e t i m**

Senati i UShAF për qëllim të harmonizimit të rregulloreve me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullore në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit të UShAF;

Rektori  
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

  




Në bazë të nenit 48 paragrafit 1.4 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 03.11.2021, miraton:

## **RREGULLOREN PËR STUDIME MASTER**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me Rregullore për studimet master (në tekstin e mëtejshëm: " Rregullore") në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: "Universiteti"), përkufizohen rregullat, procedurat dhe dokumentet e tjera shoqëruese për organizimin, vlerësimin dhe dhënien e titullit Master të nivelit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) 7, (MSc) me 120 ECTS ose MA (120 ECTS).

### **II. Qëllimi i kësaj rregullore**

#### **Neni 2**

Qëllimi i rregullores për studime master është të caktoj mënyrën e organizimit të studimeve master, që nga regjistrimi i studimeve deri në përfundim të tyre.

### **III. Organizimi i studimeve në master**

#### **Neni 3**

1. Kjo rregullore do të aplikohet nga të gjitha fakultetet dhe programet respektive të studimeve në ato fakultete.
2. Studimet master Universiteti i organizon në mënyrë autonome, duke pasur parasyshë specifikat e studimeve në Universitet. Në raste kur programet e studimit në universitet ofrohen nga një institucion tjetër apo zhvillohen në kuadër të bashkëpunimit të Universitetit me Universitetet ndërkombëtare, atëherë do të hartohet një rregullore specifike e cila e rregullon atë mënyrë të studimeve.

3. Studimet master fillojnë së implementuari pasi që të merret pëlqimi për aprovimin e Programeve nga Senati i Universitetit (në tekstin e mëtejme "Senati") dhe Akreditimi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

#### Neni 4

Me studimet master udhëheq Këshilli Mësimor/Shkencor (në tekstin e mëtejme: "Këshilli").

Përbërja e Këshillit është e rregulluar me Statutin e Universitetit (në tekstin e mëtejme: "Statuti").

#### Neni 5

Studimet master sipas programeve të fakulteteve përkatëse organizohen dhe zhvillohen si studime të rregullta.

### IV. Kushtet e përgjithshme të pranimit në programet e studimeve master

#### Neni 6

1. Studimet master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët të cilët kanë kryer studimet themelore (studimet bachelor) të drejtimit përkatës dhe që kanë fituar së paku 180 ECTS.
2. Në studimet post diplomike - master, në UShAF, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës, në të gjitha Institucionet e Akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë.
3. Të drejtë pranimi në UShAF kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës.
4. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në fushat e përafërta të studimit të identifikuar gjatë procesit të akreditimit.
5. Kandidatët, të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UShAF, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve. Kandidatët për pranim si studentë në UShAF nuk mund të konkurrojnë në më shumë se në një fakultet apo program të studimit.
6. Përzgjedhja e kandidatëve, për të gjitha fakultetet, do të bëhet sipas kriterëve si në vijim: Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
  - Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;
  - Pikët nga lëndët prioritare (5 lëndë) deri në 50 pikë.

*Handwritten signature*

7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë, jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta, atëherë do të mirret parasysh suksemi i studimeve themelore Bachelor. Nëse edhe suksemi është i njëjtë, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femrore. Në qoftëse kandidatët i takojnë gjinisë së njëjtë, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.
8. Për funksionimin e programit studimor të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve.
9. Në raste të veçanta, kriteret për pranimin e studentëve në studime master caktohen nga Senati i Universitetit, për çdo vit akademik.

### Neni 7

Për t'u pranuar në studimet master në Universitet, studentët duhet të kompletojnë këto dokumente:

- Aplikacionin (i cili shkarkohet nga sistemi i menaxhimit universitar (SMU))
- Diplomën e kualifikimit bachelor ose të ngjashme (Origjinale ose të noterizuar),
- Certifikatën e notave të studimeve bachelor (Origjinale ose të noterizuar),
- Kopjen e kartelës së identitetit,
- Ekstraktin e lindjes;
- Fletëpagesën me rastin e aplikimit të paracaktuar nga institucioni (shuma e së cilës përcaktohet nga Ministria).

### Neni 8

Për t'u regjistruar në studimet master, studentët që kanë mbaruar studimet në universitetet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuar diplomën e studimeve bachelor sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI (më shumë informacione [www.masht.gov.net](http://www.masht.gov.net)).

Studentët që nuk janë shtetas të Kosovës, pas regjistrimit të studimeve master në Universitet, në afat prej dy javësh nga data e regjistrimit duhet t'i përfundojnë procedurat e regjistrimit civil përmes zyrës së migracionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (për më shumë informacione: <https://mpb.rks-gov.net/>).

Numri i studentëve të huaj që vijnë nga viset shqiptare jashtë Kosovës e që do të pranohen në Universitet vendoset nga MASHTI bazuar në kërkesat të cilat i harton Këshilli Mësimor-Shkencor dhe i aprovon Senati i Universitetit.

### Neni 9

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studime master mund të ankohen kundër vendimit brenda 48 orë nga shpallja e rezultateve mbi pranimin në studime, Komisionit për Ankesat në Universitet.

### Neni 10

Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit, duhet të ofrojnë:

- 2 ( dy ) fotografi të formatit 4.5. x 6 cm;
- Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret aty ku bëhet regjistrimi;
- Fletëpagesën ( e cila shkarkohet nga interneti ) në shumën e cila caktohet nga Ministria.

Pas regjistrimit të studimeve, studentit i sigurohet karta e identifikimit, e-mail adresa, qasja në SMU dhe bibliotekë si dhe burimet e tjera për studim.

### Neni 11

Studimet master mund të organizohen në të gjitha Fakultetet, të cilat me planet mësimore parashohin këto studime.

### Neni 12

Të drejtën e dhënies së mësimin në studimet master e kanë i gjithë stafi akademik në UShAF.

### Neni 13

- Studimet master zhvillohen sipas sistemit semestral dhe bazohen kryesisht në lëndë të ngushta të specializimit brenda Fakulteteve në Universitet. Sistemi i punës në këto studime duhet të përfshijë edhe orët e punës praktike përkatësisht praktikën kërkimore hulumtuese të cilën duhet ta përfundojnë studentët.
- Rregullorja e studimeve, bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit, i obligon studentët që t'i vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet në Universitet.
- Të gjitha provimet në Universitet mbahen me shkrim, me gojë, me shkrim dhe me gojë, ashtu sikurse është e paraparë me syllabus.
- Komitetet programore vendosin se për cilat lëndë hyrja në provim ka parakusht dhënien e një ose më shumë lëndëve paraprake.
- Vlerësimi dhe notimi bëhet nga mësimdhënësi i lëndës brenda dy javësh prej provimit përfundimtar. Të gjitha detyrat dhe provimet ruhen për një periudhë 30 ditore.

## Neni 14

Regjimi i studimeve, sistemi i notave, sistemi i ECTS-së është i ngjashëm me studimet themelore (bachelor).

## V. Njohja e studimeve

### Neni 15

Për kalim - transferim të studentëve që studiojnë në qendra tjera Universitare në Universitet, vendos Këshilli Mësimor-Shkencor në bazë të Rregullorës për transfer të studentëve.

### Neni 16

Vendimi për njohjen e studimeve ndërkombëtare bazohet në informatat e nxjerra nga baza e të dhënave përkatëse Evropiane dhe koordinohet me Këshillin Kombëtar për Njohje, i cili është përgjegjës për aplikimin e Konventës së Lisbonës për Njohje. Në raste të tjera vendoset sipas dispozitave të Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë.

### Neni 17

1. Në pajtim me rregullat e Konventës së Lisbonës mbi njohjen dhe në pajtim me Udhëzimet administrative të MASHT, si dhe dispozitat e Statutit të UShAF-it, Universiteti pranon kualifikimet (titujt, diplomat, provimet) e institucioneve të njohura apo të licencuara, vendore ose të huaja të arsimit të lartë.
2. Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it mbi parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, është kompetencë e Universitetit që të bëjë njohjen e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare dhe të certifikatave të periudhave të caktuara të studimeve, me qëllim të vazhdimit të studimeve.
3. Në rastin e pranimit të kualifikimit, studenti ka të drejtë të vazhdojë studimet në Universitet.

### Neni 18

Procedura e njohjes do të zhvillohet në Universitet. Vendimi për njohjen e studimeve bazohet në informatat e nxjerra nga baza e të dhënave përkatëse Evropiane dhe koordinohet me Këshillin Kombëtar për Njohje, i cili është përgjegjës për aplikimin e Konventës së Lisbonës për Njohje. Në raste të tjera vendoset sipas dispozitave të Statutit të Universitetit.

### Neni 19

Vendimi i Këshillit mund të jetë:

- Njohja e plotë e diplomës nga jashtë;





- Parashtrimi i listës së provimeve shtesë që kërkohet me qëllim të njohjes së plotë;
- Refuzimi i kërkesës për shkak të mospërputhjeve kryesore në programet e studimit.

## **VI. Viti akademik**

### **Neni 20**

1. Në përputhje me Statutin, Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjatë 12 muaj.
2. Viti akademik fillon me 1 tetor dhe mbaron me 30 shtator.
3. Periudha aktive e studimeve ( ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokviumet) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror fillon me 1 tetor dhe mbaron me 15 janar. Semestri veror fillon me 16 shkurt dhe mbaron me 31 maj.
4. Lënda mund të ligjërohet 15 javë në një apo dy semestra, apo si bllok ligjëratash në një semestër.
5. Orari i ligjëratave nxirret në fillim të vitit akademik/semestrit dhe pas publikimit të tij është i obligueshëm për mësimdhënës dhe studentë.
6. Ngarkesa vjetore e studentit me ligjëratat, ushtrime, përgatitje dhe të tjera është 750 orë në semestër, respektivisht 1500 orë në vit, që korrespondon me 30 kredi në semestër apo 60 kredi në vit.

### **Neni 21**

Çdo ECTS kredi është e barabartë me 25 orë angazhim të studentit.

## **VII. VII.Gjuha e studimeve**

### **Neni 22**

1. Në Universitet, studimet organizohen në gjuhën shqipe.
2. Me propozim të Këshillit, Senati mund të vendosë për programet e studimit në gjuhë tjera në raste të argumentuara dhe nevojës (promovimi i këmbimit akademik), situata në tregun e punës, interesi i studentëve, orientimi akademik i mësimdhënësve) që favorizojnë zhvillimin akademik të Universitetit.

## **VIII. Studentët - statusi, të drejtat dhe përgjegjësitë**

### **Neni 23**

1. Personi i regjistruar në Universitete ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit vërtetohet me ID-kartën e studentit. Forma dhe përmbajtja e kartës së studentit përcaktohet me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Senati.

## Neni 24

Studentët e pranuar në Universitet kanë të drejtë të:

1. marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
2. shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë;
3. marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet e universitetit;
4. marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Këshillit, Senatit dhe struktura të tjera ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe mënyrë të sqartë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve të lartshënuara;
5. paraqesin ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga Universiteti;
6. ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e Universitetit;
7. kundërshtojnë një vendim apo një veprim të Universitetit ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente;

## Neni 25

Studentët që janë pranuar në Universitet kanë obligim:

1. T'i respektojnë rregulloret e Universitetit;
2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve;
3. T'i kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
4. Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
5. Të sillen mire në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin;
6. Të respektojnë rregullat e kodit etik të studentit;
7. Të paguajnë pagesat dhe tarifatat që janë të caktuara.

## Neni 26

1. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studenti të regjistrohet në vitin tjetër.
2. Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.

## Neni 27

1. Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:

fp.

- 1.1. Kur vendos të largohet nga studimet;
  - 1.2. Kur i ka përfunduar studimet;
  - 1.3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
  - 1.4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
  - 1.5. Kur arrin numrin maksimal të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;
  - 1.6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.
2. Këshilli zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:
- 2.1. Për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lartë;
  - 2.2. Për individët të cilët gjatë kohës së studimeve u është përkeqësuar gjendja shëndetësore të vërtetuar me certifikatë të mjekut.
- Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga Këshilli.
3. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet dëshmuara si të:
- 3.1 Sëmundjes së rëndë;
  - 3.2 Kujdesi për fëmijën nën moshën tri vjeçare;
  - 3.3 Shtatzënisë dhe lehonisë;
  - 3.4 Rastet tjera të justifikuara. Vendimi merret nga Dekani i njësisë akademike.

#### Neni 28

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda një viti pasi të ketë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studentit duhet të japë provimin diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
2. Studenti që ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te Dekani i njësisë akademike, për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit.

#### Neni 29

Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt.

#### Neni 30

Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt nuk llogaritet në kohëzgjatjen studimeve.



### **Neni 31**

Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, Këshilli Mësomor/Shkencor vendosë për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë.

### **Neni 32**

Në rast se studentit të regjistruar në vitin e parë të studimeve i lejohet suspendimi i përkohshëm dhe në ndërkohë planprogrami valid i kohës së regjistrimit nuk zhvillohet në vitin vijues, studenti duhet të vazhdoj studimet me plaprograme të reja aktuale.

### **Neni 33**

Kërkesa për suspendim të përkohshëm bëhet para fillimit të vitit akademik, përkatësisht nga data 1 Shtator deri me datën 15 shtator.

## **IX. Programet mësimore në studime master**

### **Neni 34**

Studimet në Universitet mbahen sipas programeve të studimeve, të përgatitura nga Fakultetet dhe të miratuara nga Këshilli dhe Senati dhe akredituar nga Agjencia Kosovare për Akreditim (AKA).

### **Neni 35**

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master (MSc), studentit kualifikohet për fushën përkatëse të paraparë në raportin e vetëvlerësimit (varësisht prej fushes së studimit).

## **X. Përcaktimi i suksesit akademik**

### **Neni 36**

Për përcaktimin e suksesit akademik aplikohen këto metoda:

- Provimi
- Kolokviumi
- Punimi seminarik
- Praktika profesionale
- Prezantimi.



### Neni 37

Vlerësimi i suksesit në provime bëhet me notat:

Nota në USHAF	ECTS Nota	Përqindja	Përkufizimi
10	A	90-100	SHKËLQYESHËM/EXCELLENT
9	B	80-89	SHUMË MIRË/VERY GOOD
8	C	70-79	MIRË/GOOD
7	D	60-69	KËNAQSHËM/SATISFACTORY
6	E	50-59	MJAFTON/SUFFICIENT
5+	FX/F	0-49	DOBËT/ POOR

### Neni 38

1. Provimet paraqesin mënyrë të rregullt të vlerësimit të dijes së studentit.
2. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë sipas programit të studimeve ( provim me komision).
3. Provimet mbahen në infrastrukturën e Universiteti. Ato janë publike dhe mbahen:
  - 3.1. Me shkrim;
  - 3.2. Me gojë;
  - 3.3. Me shkrim dhe me gojë;
  - 3.4. Praktike.
4. Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim mbahen brenda 7 ditëve.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës, ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
  - 6.1. Studenti është ankuar;
  - 6.2. Është caktuar me programin e studimeve.

### Neni 39

Universiteti ofron tre afate të rregullta të provimeve në studimet Master.

Procedura e mbajtjes së provimeve është e përcaktuar me programin e studimeve, ndërsa mënyra e vlerësimit të dijes së studentit në provim përcaktohet me programin mësimor të lëndës - syllabus.

#### Neni 40

1. Provimet në Fakultet mbahen gjatë afateve të provimeve.
2. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit ( janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).
3. Periudha e saktë për çdo afat përcaktohet me kalendar të përgjithshëm të studimeve dhe është e hapur për publikun.
4. Data e fillimit dhe përfundimit për çdo afati të provimeve përcaktohet nga Këshilli.
5. Oraret ditorë të provimeve shpallen në fillim të vitit akademik.
6. Oraret e provimeve përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.
7. Oraret e provimeve të shpallura janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

#### Neni 41

1. Koha e paraqitjes së provimit fillon dhjetë (10) ditë para fillimit të afatit të provimeve dhe përfundon tri (3) ditë para fillimit të afatit të provimeve;
2. Orari i provimit shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së mbajtjes së provimit.
3. Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet i dështuar dhe shënohet me notë 5.
4. Me kërkesë të tij, studentit mund t'i lejohet, nga dekani i Fakultetit që të hyjë më herët në provim po qe se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

#### Neni 42

1. Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë me shkrim dekanit të Fakultetit kundër notës së marrë. Ankesa parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.
2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:
  - 2.1. Për provimin me shkrim- parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
  - 2.2. Për provimin me gojë - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
  - 2.3. Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë;
  - 2.4. Për vlerësimin e punimit seminarik
  - 2.5 Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë;

- 2.6 Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.
3. Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa mësimdhënësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.
  4. Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
  5. Në rast të ankesës kundër notës në provim me shkrim dhe punimit seminarik, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
  6. Kundër vlerësimit të komisionit nuk mund të parashtrohet ankesë.

#### Neni 43

1. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.
2. Studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
3. Studenti pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi mbahet para komisionit prej tre anëtarësh i emëruar nga dekani.
4. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.
5. Në rast se studentit sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, humb statusin e studentit për këtë lloj të studimeve. Studenti mund të rifitojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi i Këshillit përcakton provimet dhe çështjet të tjera që i pranohen studentit dhe obligimet e studentit në programin e ri të studimeve.

#### Neni 44

1. Studimet master zgjasin 2 vite respektivisht katër semestra dhe kërkojnë arritjen e 120 ECTS, nëse me programe të veçanta nuk përcaktohet ndryshe.
2. Në rastet e parapara me syllabus të lëndës, vlerësimi i studentit në studimet master mund të bëhet edhe gjatë gjithë vitit akademik.
3. Pas përfundimit të semestrit të fundit të studimeve master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
4. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.
5. Nëse kandidati edhe në afatin e zgjatur nuk mbron punimin e diplomës, caktohet temë e re e punimit të diplomës.



## **X. PUNIMI I DIPLOMËS**

### **Neni 45**

1. Studimet master përfundojnë me mbrojtjen e punimit të diplomës, në përputhje me programin mësimor.
2. Studenti i cili ka kryer obligimet e parapara me programin mësimor, ka të regjistruar të katër semestrat dhe ka më së shumti një provim të pa dhënë, fiton të drejtën për të parashtruar kërkesë për të filluar procedurat për caktimin e temës së diplomës së masterit.
3. Titujt e temave të punimeve në master, gjatë vitit akademik iu jepen në dispozicion studentëve për përcaktim të tyre. Mësimdhënësi që ka propozuar temën është mentor potencial i asaj teme.
4. Studentët në harmoni me nevojat e ndërmarrjeve ose institucioneve hulumtuese dhe të tjera në marrëveshje me mësimdhënësit e lëndës mund të propozojnë tituj të tjerë të temës së diplomës nga lëmit përkatëse.
5. Projektpropozimi për temën e diplomës në studimet master elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studentit.
6. Projektpropozimi për temën e diplomës në studimet master mund të elaborohet bashke me dy ose tre studentë (grup kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
7. Projektpropozimi i punimit të diplomës master nga një, dy ose tre kandidat vlerësohet nga Komisioni vlerësues i caktuar nga Komisioni për Studime Master.
8. Kandidati që ka fituar të drejtën për të paraqitur temën e punimit të masterit, dorëzon projektpropozimin për aprovim në Këshillin Mësimor/Shkencor.

### **Neni 46**

Forma e rregullimit të temës së diplomës master është e rregulluar sipas Manualit për përgatitjen e temës së diplomës i aprovuar nga Këshilli.

### **Neni 47**

## **XI. Komisioni i studimeve master**

Këshilli mësimor-shkencor, në bazë të statutit të Universitetit, themelon Komisionin e studimeve master.

Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Këshilli.

Komisioni në takimin e parë bënë zgjedhjen e kryetarit të tij.





Komisioni takohet në bazë të kërkesave të studentëve për të shqyrtuar propozimet për temën e masterit.

Detyrat e këtij komisioni janë të përcaktuara në Aneksin 1 Të kësaj rregulloreje.

#### Neni 48

1. Komisioni për studime master shqyrton titujt e temave të masterit të propozuara nga mësimdhënësit ose studentët, dhe i propozon Këshillit aprovimin e temës së masterit.
2. Komisioni për studime master propozon Këshillit anëtarët e komisionit vlerësues të temës (komisioni vlerësues).
3. Punimi i masterit paraqet punën e pavarur shkencore të kandidatit me të cilën ai tregon që ka përvetësuar njohuri për të zgjedhur probleme dhe detyra shkencore e profesionale.

#### Neni 49

Komisioni vlerësues përbëhet prej tre anëtarëve të rregullt (mentorit dhe dy anëtarëve të tjerë nga stafi akademik) dhe një anëtari rezervë.

Shumica e anëtarëve të komisionit duhet të jenë nga fusha shkencore nga e cila është punuar punimi i masterit.

Njëri nga anëtarët është kryetar i Komisionit vlerësues.

Komisioni vlerësues bënë:

- Shqyrtimin e projekt propozimit dhe i rekomandon Këshillit miratimin e tij,
- Vlerësimin e punimit të temës së masterit dhe harton raportin e vlerësimit dhe dërgon atë në Këshill për aprovim, dhe
- Vlerësimin e prezantimit të temës së masterit.

Në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të merr pjesë në ndonjërin nga proceset e vlerësimit të temës së masterit, ai/ajo zëvendësohet me anëtarin rezervë.

#### Neni 50

1. Kandidati është i detyruar që të dorëzoj punimin final të temës së masterit në zyrën e shërbimit të studentëve në afat kohor prej jo më herët se 3 muaj dhe jo më shumë se një vit, prej ditës kur i është lejuar punimi i masterit.
2. Në pjesën e parë të punimit, kandidati duhet të vendos deklaratën e etikës me të cilën deklaron se puna e saj/tij është autentike dhe bartë përgjegjësi individuale për origjinalitetin e punimit.
3. Me kërkesë të kandidatit, Këshilli mund të caktoj afat të ri më së shumti deri në 6 muaj për të dorëzuar punimin e masterit. Shtyerja e afatit bëhet me një arsye të fortë siç është sëmundja apo raste të tjera të cilat i përcakton Këshilli.

AB.

4. Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin masterit në afatin e përcaktuar sipas pikes 1 te ketij neni, procedura për fitimin e thirrjes akademik do të ndërpritet me vendim të Këshillit Mësimor/Shkencor, sipas propozimit të dekanit.
5. Mentori është i obliguar të shkruaj raportin e vlerësimit për punimin e temës së masterit me të cilin dëshmon se janë plotësuar kriteret e parapara me Statut dhe me këtë Rregullore.
6. Mentori gjithashtu është i obliguar që bashkë me raportin e vlerësimit të dorëzoj edhe raportin e kontrollit të plagjiaturës.
7. Komisioni për vlerësim është i obliguar që në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, ta shkruaj raportin e vlerësimit të përshtatshmërisë, ta protokolloj në arkivin e Universitetit dhe ta paraqes në Këshillin Mësimor/Shkencor.
8. Në raportin në të cilin duhet të jenë të nënshkruar shumica e anëtarëve të Komisionit vlerësues, Komisioni vlerësues mund të propozoj që punimi të miratohet dhe kandidatit ti lejohet mbrojtja, të plotësohet apo të refuzohet.
9. Anëtari i Komisionit vlerësues i cili nuk e përkrahë raportin, detyrohet që mendimin e vet ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.
10. Në qoftë se Këshilli ia kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, kandidati duhet të bëjë plotësimin e punimit të masterit në afat prej më së largu 6 muaj. Kur Komisioni vlerësues pranon punimin e plotësuar, është i obliguar që të hartoj raport të ri mbi vlerësimin e punimit dhe të njëjtin ia dërgon Këshillit Mësimor/Shkencor në afat prej 30 ditësh, prej ditës kur e ka pranuar punimin. Raportin duhet ta përkrahin shumica e anëtarëve të Komisionit vlerësues.

#### Neni 51

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bënë plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet propozimin për titull të ri të punimi të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzoj vetëm një herë.

#### Neni 52

Në bazë të propozimit të Komisionit për vlerësim të temës së masterit, Këshilli nxjerr vendim për miratim të raportit dhe cakton afatin e diskutimit publik prej 5 ditësh.

Nëse pas diskutimit publik nuk ka pasur komente, Dekani i njësisë akademike në koordinim me anëtarët e komisionit vlerësues dhe kandidatin, cakton terminin për mbrojtjen publike të temës së masterit në afat prej 15 ditësh.

Në rastet kur gjatë diskutimit publik ka vërejtje, ato duhet të bëhen me shkrim, të dihet autori i tyre dhe ti drejtohen Këshillit Mësimor/Shkencor përmes protokolit të Universitetit. Këshilli në mbedhjen e rradhës i shqyrton komentet e parashtruar dhe merr vendim për pranimin apo hedhjen poshtë të tyre. Në rast të pranimit të komentit së parashtruar, e njejta i kthehet kandidatit për të reflektuar dhe për të marrë masa për

trajtimin e komenteve. Në këtë rast, procesi i vlerësimit të temës së kandidatit kthehet ne pikën zero, respektivisht procesi fillon edhe një here nga neni 51, pika 5.

#### Neni 53

Me rastin e dorëzimit të punimit kandidati duhet të dorëzoj shënimet biografike.

#### Neni 54

1. Punimi i diplomës master duhet të dorëzohet në formë fizike dhe të protokollohet te zyra e shërbimit të studentëve së paku një ditë para datës së mbrojtjes së punimit .
2. Punimi i diplomës master dorëzohet në 6 kopje identike (lidhje e fortë).
3. Lajmërimi i datës së mbrojtjes publikohet në tabelen e shpalljeve dhe Ueb. Faqen elektronike të Univeritetit.
4. Nëse kandidati nuk e mbron punimin e diplomës master për shkaqe të pa arsyeshme në afatin sipas nenit paraprak, Këshilli, me propozim të komisionit para të cilit është dashtë të kryhet mbrojtja e punimit, me vendim ndërprejnë procedurën për fitim të thirrjes akademike të masterit dhe kandidatit i kthehet punimi i masterit.

### XII. Plagjatura dhe e drejta intelektuale

#### Neni 55

1. Universiteti mban autorësinë e punimit të temës së masterit, punës studimore që është bërë në të, rezultateve të studimit dhe çdo përfitimi potencial që mund të del nga rezultatet e punimi të masterit të studentit.
2. Studenti është përgjegjës për përmbajtjen e punimit të diplomës së masterit. Universiteti (Mentori), përmes platformave anti-plagjaturë, bënë vlerësimin e përmbajtjes së punimit të diplomës master. Në një punim të diplomës së masterit duhet që së paku 70% e punës së studentit të jetë e tij/saj.
3. Në rast kur vërtetimi i autenticitetit të punimit nuk mund të vërtetohet, studenti obligohet që në punimin e tij/saj të vëmposë një deklaratë përmes së cilës konfirmon që tema është punë vetanake dhe se nuk është e huazuar. Në momentin e aplikimit të softuerit anti-plagjature, Universiteti e gëzon të drejtën e testimit të temave të diplomës së masterit të fituara pas aprovimit të kësaj rregulloreje. Në rast të shkeljes së dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, Universiteti e dërgon studentin në Këshill të Etikës.

### XIII. Procedura e mbrojtjes

#### Neni 56

1. Kryetari i Komisionit vlerësues e hap mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e



vendimit mbi lejimin e mbrojtjes së punimit të diplomës si dhe paraqet të dhënat biografike dhe të tjera të kandidatit.

2. Kandidati bënë prezantimin e punimit, por jo më gjatë se 30 minuta.
3. Pastaj kandidati u përgjigjet pyetjeve të komisionit dhe auditoriumit.
4. Kur komisioni konstaton se punimi i masterit është shqyrtuar dhe shkoqitur në masë të mjaftuar, kryetari bënë përfundimin e mbrojtjes dhe fton komisionin për vlerësim të temës së mbrojtur.
5. Vendimi shpallet publikisht.

#### Neni 57

Kandidati ka mbrojtur punimin e masterit nëse komisioni vlerësues e vlerëson mbi 50 deri 100 pike dhe tërheqë kredi të caktuara ECTS sipas programit mësimor. Vlerësimi bëhet sipas formularit të veçantë me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës.

Kandidati konsiderohet se ka mbrojtur punim me sukses nëse vlerësohet deri në 80 pikë, ndërsa nëse vlerësohet mbi 80 pikë konsiderohet se ka mbrojtur punimin me sukses të dalluar.

#### Neni 58

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master kandidati fiton thirrjen akademike master varësisht prej fushës studimore të kryer.

#### Neni 59

Nëse kandidati nuk mbron me sukses punimin e masterit, mund të paraqesë propozim të ri brenda 6 muajve prej ditës së njoftimit se punimin nuk e ka mbrojtur me sukses.

#### Neni 60

Pas arritjes së thirrjes akademike kandidatit i lëshohet certifikata e diplomimit si dhe diploma e Universitetit.

#### Neni 61

Nëse pas punimit të masterit konstatohet se punimi nuk është i pavarur, Senati me rekomandim të Këshillit gëzon të drejtën që kandidatit ti tërhiqet grada shkencore e fituar.

### XIV. Organizimi i studentëve

#### Neni 62

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'iu përkasin të gjithë studentët.

2. Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregullore të përgjithshme të nxjerra nga Këshilli Drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.

#### Neni 63

Interesat e studentëve përfaqësohen në Parlamentin e studentëve në nivel të Universitetit.

#### Neni 64

1. Anëtarët për Parlament të studentëve zgjidhen në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet studentore.
2. Propozimet për anëtarë të Parlamentit bëhen në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
3. Nominimi, mandati, numri i anëtarëve Parlamentit të Studentëve si dhe zgjedhja e tyre, përcaktohen me Statut si dhe Rregulloren mbi punën e Parlamentit të Studentëve.

### XV. Përgjegjësia disiplinore

#### Neni 65

1. Studentët të cilët bëjnë shkelje të kësaj rregullore apo edhe akteve tjera ligjore në Universitet, rastet e tyre dërgohen në Komision Disiplinor.
2. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjoen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon Këshillin.
3. Këshilli i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat.
4. Komisioni disiplinor ka të drejtë të shqyrtoj edhe rastet e studentëve të diplomuar për të cilët dyshohet se kanë shkelur nenin 56 të kësaj rregullore. Në këto raste Komisioni disiplinor gëzon të drejtën të marrë titullin e Masterit të Shkencave të fituar nga studenti dhe diplomën e marrë nga studenti t'a anuloj dhe të kërkoj nga studenti t'a kthejë atë.
5. Studentët e ndëshkuar me masë disiplinore kanë të drejtë t'i ankohen Komisionit të ankesave në afat prej 15 ditëve prej ditës së shpalljes së vendimit si organ i shkallës së dytë.
6. Komisioni i ankesave është i obliguar që t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë Këshillit brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
7. Ankesa rreth vendimit të shkallës së dytë vendoset nga Senati.

#### Neni 66

Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

1. Procedurat rreth inicimit, marrjes në pyetje dhe vendosjes lidhur me përgjegjësitë e studentëve, përcaktohen me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Këshilli Drejtues.

## **XVI. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

### **Neni 67**

Për çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit.

### **Neni 68**

Kjo rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

### **Neni 69**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

### **Neni 70**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për studime master nr. 48/20 e datës 09.01.2020.

Kryesuesi i Senatit

Prof. Dr. Agron Bajraktari, Rektor



## **Anex 1**

### **Përshkrimi i detyrave të Komisionit për studimet master**

- 1. Shqyrtimin e propozimit të titujve të temave të diplomave të studimeve master të propozuara nga mësimdhënësit, i aprovon apo i refuzon ato,**
- 2. Propozon Këshillit Mësimor/Shkencor mentorin për udhëheqje të temës së propozuar të diplomes master**
- 3. Propozon Këshillit Mësimor/Shkencor anëtarët e komisionit vlerësues për shqyrtimin e propozimit, vlerësimin dhe mbrojtjes publike të punimit të temave të diplomës master.**

